Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë kundër zjarrit–mësimi lëndor	**Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë**	**Ekipi për mbrojtje kundër zjarrit**	**Aparatet kundër zjarrit**	**Ekipi është aftësuar për aksion**	**Nëntor**
Evaulimi i aktiviteteve të realizuara	**Shqyrtimi i lëshimeve**	**Ekipi i arsimtarëve**	**Plani dhe procesver bali**	**Lëshimet janë vërejtur dhe evituar**	**Nëntor**
Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë kundër zjarrit–mësimi klasor	**Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë**	**Ekipi për mbrojtje kundër zjarrit**	**Aparatet kundër zjarrit**	**Ekipi është aftësuar për aksion**	**Shkurt**
Evaulimi i aktiviteteve të realizuara	**Shqyrtimi i lëshimeve**	**Ekipi i arsimtarëve**	**Plani dhe procesver bali**	**Lëshimet janë vërejtur dhe evituar**	**Shkurt**
Testimi i sinjaleve për rezik	**Kontrollimi i suksesshmërisë së sinjalit**	**Ekipi për planifikim**	**Plani**	**Nxënësit e njohin shenjën**	**Prill**
Aktivitet ushtrues për ndihmën e parë mjekësore	**Aftësimi i ekipit për ndihmë të shpejtë**	**Ekipi për ndihmë të shpejtë**	**Materiali medicinal**	**Intervenim praktik dhe i suksesshëm**	**Maj**
Evaulimi i aktiviteteve të realizuara	**Shqyrtimi i veprimeve pozitive dhe negative**	**Ekipi i arsimtarëve**	**Procesverba let**	**Janë shqyrtuar masat e mëtutjeshme**	**Maj**

PLANI PËR MBROJTJE NGA TËRMETET DHE FATKEQËSITË TJERA ELEMENTARE NATYRORE

PËRMBAJTJA-AKTIVITETI	Qëllimet	Realizator	Resurset	Efektet e pritura	Koha
Testimi i sinjaleve për rezik	Caktimi i sinjalit të vërtetë	Ekipi për planifikim	Plani	Nxënësit e njohin shenjën	Shtator
Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë – mësimi lëndor	Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë	Ekipi për evakuim të shpejtë	Plani skematik	Ekipi është aftësuar për aksion	Tetor
Aktivitet ushtrues për evakuim të shpejtë – mësimi klasor	Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë	Ekipi për evakuim të shpejtë	Plani skematik	Ekipi është aftësuar për aksion	Nëntor
Evaulimi i aktiviteteve të realizuara	Shqyrtimi i lëshimeve	Ekipi i arsimtarëve	Plani dhe procesverbali	Lëshimet janë vërejtur dhe evituar	Shkurt
Aktivitet ushtrues për ndihmën e parë mjekësore	Aftësimi i ekipit për ndihmë të shpejtë	Ekipi për ndihmë të shpejtë	Materiali medicinal	Intervenim praktik dhe i suksesshëm	Prill
Evaulimi i aktiviteteve të realizuara	Shqyrtimi i veprimeve pozitive dhe negative	Ekipi i arsimtarëve	Procesverbalet	Janë shqyrtuar masat e mëtutjeshme	Maj

16. Kujdesi për shëndetin e nxënësve

Kujdesi dhe përmirësimi i shëndetit të nxënësve është obligim i të gjithëve në shkollë, i të gjithëve që mësojnë dhe punojnë në të, në bashkëpunim me prindërit, institucionin shëndetësor dhe rrethin më të gjërë. Shkolla do të punojë me programë për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të nxënësve në bashkëpunim me organet shëndetësore.

Qëllimi i programës është që t`i aftësojë nxënësit dhe të punësuarit në shkollë si dhe bashkësinë vendore që të mund të ndërmarrin aksione preventive për mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit të nxënësve dhe të punësuarve në shkollë.

Lëmitë dhe përmbajtjet:

- Përmirësimi i shëndetit fizik të nxënësve (higjiena, ushqimi i shëndetshëm, preventiva nga sëmundjet ngjitëse, mbrojtja nga substancat narkotike droga, alkooli, pirja e duhanit) etj;
- Përmirësimi i shëndetit mendor (zhvillimi i vetëbesimit, respekti i ndërsjelltë, komunikimi dhe të kuptuarit e të tjerëve dhe pranimi i tyre në shoqëri);

Shëndeti mendor përfshin mirëqenien tonë emocionale, psikologjike dhe sociale. Ajo ndikon në mënyrën se si mendojmë, ndjejmë dhe veprojmë kur përballemi me jetën. Gjithashtu ndihmon në përcaktimin se si përballemi me stresin, si lidhemi me të tjerët dhe si marrim vendime. Shëndeti mendor është i rëndesishëm në të gjitha fazat e jetës, nga fëmijeria dhe adoleshenca deri në moshën madhore dhe pleqëri.
Shëndeti mendor është i rëndësishëm sepse ju ndihmonë:

- Të përballeni më lehtë me streset e jetës
- Të jeni fizikisht të shëndetshëm
- Të krijoni marrëdhënie të shëndetshme
- Të jepni një kontribut të rëndësishëm për komunitetin ku jetoni
- Të punoni në mënyrë produktive
- Të shfrytëzoni plotësisht potencialin tuaj

- Shëndeti social (shoqëror) (kujdesi për ambientin e ngrohtë dhe të shëndetshëm, principet e organizimit të ambientit familjar, rrethit shkollor më të shëndetshëm , komunikimi mes nxënësve, arsimtarit-nxënësit-prindit dhe anasjelltas).

Përmbajtjet duhet të jenë konkrete të realizohen gjatë mësimit të rregullt, në orën e bashkësisë së klasës, aktivitetet e lira dhe aktivitetet të planifikuara për lëmitë konkrete. (Programa si shtojcë)

PLAN PROGRAMI SHËNDETSOR

Kujdesi i shkollës për shëndetin e nxënësve 2025/2026

Përmbajtja e aktivitetit	Qëllimi i aktivitetit	Mënyra e realizimit	Mjetet për realizim	Koha e realizimit	Realizator
Kontrollimet sistematike	Zbulimi i hershëm i deformiteteve dhe anomalitë tjera të nxënësit	Kontrolli me mjeksore		Sipas orarit të Qendrës Medicinale	Doktor për mjeksi shkollore
Aksion për sigurimin e nxënësve nga kl. I-IX	Nxënësit të njihen me përparësitë e sigurimit dhe me atë të kaplohen më tepër nxënës	Biseda		Tetor	Të gjithë arsimtarët
Dhëmbë të shëndetshëm organizë`m të shëndetshëm	Të përcillen njohuri për mbajtjen e dhëmbëve të shëndetshëm dhe mbajtja e protezave	Ligjëratë-bisedë	Revista, fotografi , placate	Nëntor	Njerëz professional
Rreziqet nga materialet shpërthyese (petardat) – fishekzjarret	Të njoftohen me rreziqet nga materialet eksplozive	Ligjëratë, bisedë		Dhjetor	Njerëz professional
Jetë të shëndetshme në ambient të shëndetshëm	Ti zhvillojnë njohuritë nga ekologjia	Ligjëratë, biseda, krijime individua le	Puna në teren, fotografi , tekste	Janar	Arsimtar nga biologjia
E diela lufta kundër narkomanisë, nikotinizmit dhe alkoolizmit	Të theksohet rreziku nga këta sëmundje të varshmërisë	Ligjëratë, bisedë	Tekste, fotografi ,material propaga ndues	Shkurt	Arsimtarët klasor

Java e Luftës kundër kancerit	Njohja me rreziqet nga kjo sëmundje	Ligjëratë	Tekste, fotografi	Mars	Arsimtarët klasor
Festimi i 7 prillit - Ditës ndërkombëtare të shëndetit	Të njihen me rëndësinë e 7 prillit	Ligjëratë		Prill	Arsmtarët klasor
Sëmundja ngjitëse verdhëza, zgjebja, gripi kovid 19 etj.	Të mësojnë se si të mbrohen nga këto sëmundje	Ligjëratë	Tekste, fotografi	Maj	Biolog

16.1. Higjiena në shkollë

Higjiena në shkollë do të mbahet si më parë nga stafi teknik, por me një angazhim aktiv edhe të të gjithë punonjësve tjerë. Kujdestarët e klasave dhe të gjithë arsimtarët e tjerë do të kenë një rol të rëndësishëm, duke u treguar vazhdimisht nxënësëve rëndësinë e higjienës dhe përmes aktiviteteve për ndërtimin e shprehive higjienike midis nxënësëve. Prindërit poashtu duhet të luajnë një rol të rëndësishëm.

16.2. Kontrollimet sistematike

Kontrollimet sistematike do të bëhen gjatë vitit shkollor sipas Ministrisë së shëndetësisë ku do të përfshihen nxënës nga të gjitha klasat dhe do të realizohen në Shtëpinë e Shëndetit - Tetovë.

16.3. Vaksinimi

Vaksinimi do të realizohet si pjesë e kujdesit për shëndetin e nxënësve që do të kryhen në shkollën tonë, dhe realizimi do të bëhet nga një ekip mjekësor nga institucioni shëndetësor.

Aktivitetet	**Klasat**
Kontrollim sistematik	I, III, V, VII
Vaksinimi MRP	I
Ekzaminimi dentar dhe mbushja e dhëmbëve të parë të përhershëm	I, II, III, IV, V, VI, VII.
D-T + polio	II
HPV - vaksinimi	VII
D-T+ polio	IX

16.4. Higjiena menstruale

Të kujdesesh për veten, për higjienën menstruale është po aq e rëndësishme sa të kujdesesh për aktivitetet e përditshme. Nëse anashkalohet menaxhimi i higjienës menstruale sado pak mund t'i shkaktoni trupit dëm të rëndë dhe gjithashtu mund të bëheni shkaktar për përhapjen e infeksionit tek vetvetja dhe tek të tjerët.

Këtë vit në shkollën tonë është planifikuar të mbahen ligjërata nga psikologja e shkollës me grupe nxënësesh vajza duke filluar nga klasa e V-IX për të treguar rëndësinë e higjienës menstruale, sidomos gjatë qëndrimit në shkollë duke pasur parasysh se shfrytëzojnë tualete publike ku mundësia e përhapjes së infeksioneve është dukshëm më e madhe.

16.5. Edukimi për ushqim të shëndetshëm

Edukimi i këtij lloji do të realizohet përmes një seri aktivitetesh dhe projekteve të realizuara nga arsimtarët në shkollë duke vizituar institucione të caktuara. Aktiviteti "Ushqim i shëndetshëm për fëmijëri të përsosur" do të realizohet edhe këtë vit.

17. KLIMA DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLË

17.1. Disiplina

Një prej detyrave parësore në çdo institucion edukativo-arsimor është disiplina e përgjithshme në shkollë. Gjatë vitit shkollor 2024/2025, në shkollë të gjitha subjektet që marrin pjesë në realizimin e procesit edukativo–arsimor dhe të punësuarit tjerë ndikojnë në krijimin e mirëkuptimit dhe tolerancës në shkollë ku çdo nxënës dhe i punësuar do të ndjehet i sigurtë dhe i respektuar.

Në fillim të vitit shkollor udhëheqësit e paraleleve do t'i njoftojnë nxënësit me rregullat dhe obligimet e tyre si nxënës. Shkolla ka rregullore për të gjitha detyrat dhe obligimet në shkollë e cila rregullore do të vendoset në vendin përkatës në shkollë.

Arsimtarët janë të obliguar për ndjekjen e disiplinës së nxënësve gjatë kohës së pushimeve ndërmjet orëve. Prandaj kemi orar për arsimtarët kujdestar që do të kujdesen për disiplinën e nxënësve gjatë kohës së pushimeve në korridore, mësonjëtore , tualete dhe oborrin e shkollës. Këto shënohen në raportin ditor për të gjitha ngjarjet që ndodhin gjatë ditës nga kujdestarët e ditës.

17.2. Regullimi estetik dhe funksionl i hapësirës në shkollë

Të gjithë të punësuarit në shkollë janë të obliguar të kontribuojnë në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të mirave matriale në shkollë me qëllim të funksionimit dhe komoditetit më të mirë. Arsimtarët do të kontribojnë për rregullimin estetik dhe funksional të shkollës me punime, projekte dhe prezantime, natyrisht me nxitje në kontinuitet të nxënësve për të njëjtat aktivitete. Punimet do të vendosen në vende të përshtatshme në mësonjëtore dhe korridore.

Në shkollë organizohen ngjarje të llojlojshme, realizimi i të cilave kërkonë përkushtim të veçantë dhe adekuat. Pamja e shkollës është pasqyrë e rëndësishme për nxënësit në angazhimin e tyre maksimal në procesin edukativo-arsimor. Prandaj edhe këtë vit do të zgjedhim mësojëtoren më të mirë të rregulluar dhe mirëmbajtur, nxënësit e asaj klase do të shpërblehen.

17.3. Kodekset etike

Gjatë muajit Tetor të vitit shkollor 2025/2026 do të përpilohen kodekse për sjellje për të gjithë subjektet në shkollë.

- Kodeksi etik i arsimtarëve
- Kodeksi etik i nxënësve
- Kodeksi etik për të punësuarit tjerë
- Kodeksi etik për prindërit
- Eko-kodeksi

Të gjthë kodekset do të vendosen në vende të dukshme për nxënësit, arsimtarë, prindërit dhe punëtorët tjerë. Kodekset - rregulloret janë si program shtesë i programit për punën në shkollë.

17.4. Marëdheniet në mes gjithë strukturave

Për mirëqenien e marëdhenjeve të mira të gjitha grupeve etnike janë planifikuar aktivitete te përbashkëta, manifestimet e përbashkëta, ekspozitat e nxënësve, me përfaqësim të drejtë në të gjitha lëmitë për të gjithë nxënësit.

18. ZHVILLIMI PROFESIONAL – PEDAGOGJIK I KUADRIT ARSIMOR

Arsimimi profesional pedagogjik dhe përparimi është nevojë dhe obligim i kuadrit arsimor dhe ajo paraqet një kusht shumë të rëndësishëm për realizimin e suksesshëm dhe organizimin e përgjithshëm të punës edukativo-arsimore në shkollë.

Nevoja e këtillë del parasegjithash nga praktika pedagogjike e cila çdo ditë pasurohet me inovacione, të cilat nga arsimtari kërkojnë të shkojë në hap me kohën, t'i përcjell dhe t'i zbatoj në atë mënyrë që të perparojë vetë për mësimdhënie më cilësore në shkollë. Përparimi profesional pedagogjik i arsimtarëve dhe punëtorëve tjerë profesional do të realizohet nëpërmjet:

❖ Përpjekjeve individuale

- Përcjelljes së revistave profesionale pedagogjike dhe literaturës pedagogjike e cila mund të gjendet në shkollë dhe jashtë saj;
- Shfrytëzimi individual i burimeve të ndryshme hulumtuese: libra, revista të ndryshme arsimore, doracak, enciklopedi e të tjera;
- Prezenca dhe pjesëmarrja në seminare, këshillime,trajnime të ndryshme etj.

❖ Përpjekjeve kolektive

- Nëpërmjet punës së aktiveve profesionale;
- Në kuadër të punës të Këshillit të arsimtarëve (nëpërmjet përpunimit të analizave profesionale pedagogjike, deklaratave, informacioneve për shkak të popullarizimit të të dhënave, efikasitetit në punë, motivimin e mëtutjeshëm në punë, deklarimi i aktivit më të suksesshëm profesional, grup arsimtarësh ose individ me qëllim që të përparohet në procesin edukativo-arsimor);
- Nëpërmjet seminareve,trajnimeve etj.

18.1. Nxënie horizontale

Aktivitet	Realizator	Koha e realizmit
Mbështetje për arsimtarët në zgjedhjen e nxënësëve për bashkësinë e nxënësëve, doracak për "Pjesëmarrje demokratike e nxënësëve në shkollë".	Ekipi shkollor për integrimin ndëretnik	Shtator
Mbështetja e arsimtarëve për të kryer aktivitete me nxënës të përbërjeve të ndryshme etnike, Punëtori nga Doracaku i Aktiviteteve për pjesëmarrje të përbashkët të nxënësëve me përbërje etnike të përzier	Ekipi shkollor për integrim ndëretnik në bashkëpunim me shkollën partnere	Shtator Tetor
Strategjitë për të zvogëluar ngacmimin dhe sulmin sajber në internet, Ekipi shkollor për sjellje jo të dhunshme		Nëntor

18.2 Zhvillimi në karrierë i kuadrit edukativo-arsimor

Arsimtarët e shkollës fillore dhe të mesme mund të promovohen në tituj. Kategoria arsimtarë merret duke kaluar një provim profesional për arsimtarë. Arsimtarët mund të promovohet në titujt arsimtarë mentor dhe arsimtarë-këshilltar. Standardet profesionale për titujt arsimtarë-mentor dhe arsimtarë-këshilltar dhe mënyrën e arritjes përcaktohen nga Ministria e Arsimit she Shkencës me propozimin e Byrosë dhe Qendrës. Numri i arsimtarëve që mund të marrin titujt arsimtarë-mentor ose arsimtarë-këshilltar për secilën komunë, emërohet nga Ministri, me miratimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore.

19. Bashkëpunimi i shkollës fillore me prindërit-kujdestarët

19.1. Përfshirja e prindërve / kujdestarëve në jetën dhe punën në shkollë

Në shkollë do të veprojë në vazhdimësi Këshilli i Prindërve i cili do të përbëhet nga një anëtar (prind) i çdo klase, një arsimtar nga çdo aktiv dhe do të përgatitet programi i punës nga Kryetari i Këshillit të prindërve. Ky program ofrohet në mënyrë që prindërit të veprojnë më të organizuar në kuadër të nevojave të shkollës, përmirësimin e kushteve të punës, dhe vendimmarrje në interes të përmirësimit të mësimdhënies në shkollë, duke organizuar dhe miratuar orarin për takime me prindër , organizimin e ekskursioneve dhe të tjera. Ky Këshill do të takohet sipas nevojës me rendin e ditës të përgatitur paraprakisht.

19.2. Përfshirja e prindërve / kujdestarëve në procesin e mësimit dhe aktivitetet jashtëshkollore

Prindërit do të përfshihen në procesin e të mësuarit me atë që do të jenë të informuar në lidhje me plan-programin mësimor, dhe vetë procesin e mësimdhënies në mënyra të ndryshme: - Nëpërmjet Këshillit të Prindërve - Nëpërmjet takimeve individuale dhe në grupe me arsimtarët - Nëpërmjet shërbimit profesional të shkollës - Nëpërmjet ditarit elektronik. Me këtë do t'u jepet mundësi për t'u informuar në kohë dhe për të vepruar në kohë në çështjen e suksesit dhe sjelljes së fëmijëve të tyre. Pjesëmarrja e prindërve në procesin mësimor do të drejtohet drejt dhënies së

ndihmës në përgatitjen e mjeteve mësimore dhe materialeve didaktike për mësimdhënie kreative për Programën vjetore për punën e shkollës për vitin shkollor 2025/2026.

Në aktivitetet e shkollës

Do të merren në konsideratë sugjerimet nga ana e prindërve për sa i përket pjesëmarrjes në ngjarje të ndryshme (shitjet, ekspozitat dhe aksionet e mbledhjes në shkollë) si ndihmës në përpunimin e produkteve varësisht nga tema, promovimeve, si dhe vizitë në disa institucione dhe objekte të cilat janë ngushte të lidhura me plan-programin mësimor. Në sjelljen e vendimeve, si anëtarë të organeve shkollore do të marrin pjesë në mënyrë aktive në dhënien e propozimeve për marrjen e vendimeve në lidhje me realizimin e ekskursioneve, pajisjet e shkollës, organizim i prezantimeve dhe diskutime për tema me interes për nxënësit dhe prindërit, rregullimin e mjedisit të shkollës, etj .

19.3. Edukimi i familjeve

Do të organizohen punëtori edukative për prindërit, si pjesë e Këshillit të prindërve, takimeve të prindërve, dhe forma të tjera të punës me prindërit, takime me shërbimin profesional në funksion të këshillimit të prindërve, si dhe takime individuale dhe takime në grupe të vogla me karakter edukativ.

Përpunimi i broshurave për prindër

Me qëllim që prindërit të njihen më mirë me strukturën dhe punën e shkollës përgatitet një broshurë që ju jepet prindërve dhe secilit që është i interesuar për shkollën tonë.

20. Komunikimi me opinionin dhe promovimi i shkollës fillore

Shkolla rregullisht organizon ngjarje, manifestime dhe festa në mënyrë që të intensifikojë bashkëpunimin midis institucioneve dhe shkollës në nivelin lokal dhe të inkurajojë dhe zhvillojë bashkëpunim të ndërsjelltë.

	Lloji i aktivitetit	Koha e realizimit	Përgjegjës	Lloji i aktivitetit
Komunitet lokal	Komuna e Tetovës - sektori arsimor	Shtator, Qershor		Ngjarje sportive
	Komuna e Tetovës- sektori arsimor	Shkurt		Dita Botërore e Gjuhës së nënës
	Komuna e Tetovës- sektori arsimor	Shkurt		Shënimi i ditës së komunës
	Komuna e Tetovës- sektori arsimor	Shtator, Qershor		Sipas nevojave të komunës
Institucionet dhe shoqatat kulturore	Muzetë e shkencës natyrore	Shtator		Vizitë në një muze
	Muzeu Arkeologjik Etnologjik	Shtator, Qershor		Vizitë në një muze
	Teatër	Dhjetor		Duke vizituar një shfaqje teatrore
	Kinema	Shkurt		Vizitë në kinema
	Vizitë në Hidrocentralin e Lumit Shkumbin	Tetor		Aktivitetet jashtëshkollore
	Opera dhe Baleti i Maqedonisë	Shtator - Qershor		Duke vizituar një shfaqje baleti
Festival për fëmijë	Bletëzat	Tetor		Pjesëmarrja në konkurs
Institucionet në fushën e arsimit	Shkolla fillore	Shtator - Qershor		Bashkëpunimi me shkollat në nivelin komunal
	BZHA	Vazhdimisht		Bashkëpunim në planin edukativo arsimor
	Qendra për gjuhë të huaja	Shtator - Qershor		Mësoni gjuhë të huaja
OJQ-të	Pakomak	Shtator / Dhjetor / Prill		Projekti - Riciklimi i plastikës
	GO grin	Shtator / Dhjetor / Prill		Në projektin "Filloni një ndryshim"

	LOJA	Mars		Bashkëpunim me qendren per aktivitete te ndryshme
Klubet sportive	Klubet e notit	Shtator - Qershor		Zhvilloni aftësi për not
	Shoqëritë kulturore të artit	Shtator - Qershor		Kultivimi i shprehive për art
	Klubet e basketbollit	Shtator - Qershor		Trajnimet
Organizata shëndetësore	Spitali Klinik i Tetovës	Tetor		Kontrollimet sistematike dhe imunizimi
	Qendra e dëgjimit dhe të folurit	Tetor		Detektimi dhe kontrollimi i dëgjimit dhe të folurit
	Spitali Klinik i Tetovës	Mars		Kontrollim stomatologjik
Media	Shfaqje edukative për fëmijë	Tetor / Prill		Pjesëmarrja në një shfaqje edukative për fëmijë
	Televizioni lokal	Tetor / Shkurt / Prill		Bashkëpunim me televizionin lokal

21. PROGRAMI PËR AFTËSIMIN E DHËNIES SË PROVIMIT

TË ARSIMTARIT - PRAKTIKANT _____

Muaji	Përmbajtja e punës
Shtator	❖ Dhënia e udhëzimit për planifikimin e mësimit - Planifikimi vjetor - Planifikimi tematik - Planifikimi i orës mësimore ❖ Dhënia e udhëzimeve për udhëheqjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike ❖ Njohja me kushtet didaktiko-hapsinore (kabineti për informatikë, medioteka, biblioteka shkollore, etj.)
Tetor	❖ Dhënia e udhëzimit për shfrytëzimin e metodave dhe formave mësimore për punë. ❖ Dhënia e udhëzimit për shfrytëzimin e teknikave bashkëkohore për mësimdhënie ❖ Vizita e orës së kolegut me përvojë nga aktivi profesional (vizita e mentorit) ❖ Ndjekja, vlerësimi dhe notimi i të arriturave të nxënësve ❖ Ndihma në përgatijen e instrumenteve për vlerësim dhe notim
Nëntor	❖ Përdorimi i mjeteve konkretizuese
Dhjetor	❖ Dhënia e udhëzimeve për komunikim me nxënësit, kolegët, drejtorin, shërbimin pedagogjik, etj. ❖ Bashkëpunimi me prindët dhe bashkësinë lokale
Janar	❖ Njohja me projektet shkollore ❖ Pjesëmartrja në projektet që realizohen në shkollë ❖ Udhëzime për të shprehurit në mësim ❖ Udhëzime për bërjen e portfolios së nxënësve ❖ Udhëzime për portfolion e arsimtarit
Shkurt	❖ Dhënia e udhëzimeve për zgjedhjen e temave për detyrë shtëpie ❖ Njohja me rregulloren për dhënien e provimit profesional ❖ Njohja me Ligjin për Arsimin Fillor ❖ Hulumtimi i problemeve të caktuara në mësim ❖ Ndihma në përgatitjen e detyrave të shtëpisë

Mars	❖ Hulumtimi i problemeve të caktuara në mësim ❖ Ndihma në përgatitjen e detyrave të shtëpisë
Prill	❖ Hulumtimi i problemeve të caktuara në mësim ❖ Ndihma në përgatitjen e detyrave të shtëpisë
Maj	❖ Ndihma në përgatitjen e detyrave të shtëpisë
Qershor	❖ Dhënia e ndihmës për përgatitjen e realizimit të orës para aktivit profesional
	❖ Dhënia e mendimit për punën e praktikantit ❖ Ndihma për përgatitjen e orës për provimin profesional

Mentori gjatë stazhit të praktikantit në kontinuitet ndjek punën e praktikantit

_____

Mentor: _____

22. PROGRAMI "Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor të Maqedonisë"

PLANIFIKIMI I INTEGRİMİT

I. EKO – STANDARD: KURSIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Polisa: Shfrytëzimi racional i energjisë elektrike dhe energjisë termike në ndërtesën e kopshtit.
Qëllimi: Ulja e konsumit të energjisë elektrike dhe energjisë termike nga 10 për qind në krahasim me vitin e kaluar.

Pika e aksionit	**Subjekti**	**Përmbajtja mësimore**	**klasa/ Viti**	**Koha e realizimit**
Parashtrim i udhëzimit për shfrytëzim racional të energjisë elektrike dhe të nxemjes				
	Arsim tek.	Shfrytëzimi i energjisë së diellit,erës,ujit	V-VI	III-IV
	Fizikë	Izolimi i nxehtësisë	VII	V
	Fizikë	Mënyra e kursimit të energjisë elektrike	VIII	XI
	Biologji	Fitimi i energjisë në forma të ndryshme	VI-9	VI
	Nj.mjedisit	Përdorim i drejtë i aparateve elektrike	II	XI
	Gj. Shqipe	Ushtrime gojore: Përdorimi i aparateve në amvisëri	V-2, V-3, V-4	XI

II. EKO – STANDARD: KURSIMI I UJIT

Polisa: Shfrytëzimi racional i ujit në ndërtesën dhe oborrin e kopshtit.

Qëllimi: Ulja e konsumit të ujit nga 10 për qind në krahasim me vitin e kaluar

Pika e aksionit	**Subjekti**	**Përmbajtja mësimore**	**klasa/ Viti**	**Koha e realizimit**
Sigurimi i ujit teknik për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta në oborre me vendosjen e tubave të ujit apo instalacione të tëra për grumbullimin e shiut				
	Matematikë	Punë me të dhëna: Hulumtimi mujor për shpenzimet dhe kursimet e ujit- Operacionet aritmetike me numrat natyror	VI	X
	Nj.mjedisit	Uji në natyrë - shfrytëzimi	III-2, III-3, III-4	XII
	Ars.fizik	Pastrimi dhe larja e tereneve sportive me ujë teknik		X-IV
	Ars.figurativ	Pikturim lumi në qytetin tonë	I	III
	Biollogji	Ndërtimi i materieve të bimët	VI	II
	Ars.figurativ	Pikturim- Lumi në qytetin tonë	I	III
	Fizikë	Shtypja hidrostatike	VII	XI
	Kimi	Dekantimi filtrimi	VII	XI
	Gj.Shqipe	Pa ujë s'ka jetë: tregime, poezi, ese, lojë e tjerë.	VI,VII, VIII	III-IV
	Nj. mjedisit	Higjena personale	II	X-XI
	Gj.gjermane	Pa ujë s'ka jetë; nxehmja globale	VI,VII,VIII	III-IV

III. EKO-STANDARD: Mirëmbajtja e ndërtesës dhe mjedis të shëndetshëm në shkollë.
Polisa: Objekt i pastër dhe shëndetshëm për qëndrim dhe punë.
Qëllimi: Sigurimi i kushteve të shëndetshme për qëndrim dhe punë në shkollë.

Pika e aksionit	**Subjekti**	**Përmbajtja mësimore**	**klasa./ Viti.**	**Koha e realizimit**
Formim i eko-patrullave (grup nxënsish) të kycur në realizimin e pikave akcionale , që do të ndjekin, mbykqyrin dhe do e kontrollojnë implementimin e aktiviteteve të përmendura				
	Sh. Natyrore	Fitimi i energjisë në forma të ndyshme	VI-	VI - gjatë vitit në mënyrë të kohëpasëkohshme
	Biologji	Ndërtimi i materieve te bimët	VI	II
	Biologji	Kontrolli-ekologjik në natyrë	VII	VI
	Biologji	Aktivitetet e njeriut në biosferë	VIII	V-Dita e drurit
	Ars.muzikor	Përpunimi i një kënge – lidhur me ekologjinë në pranverë	VI, VII, VIII	III
	Gjuhë angleze	Si ta ruajmë mjedisin jetësor - formimi i EKO-Patrollave	VI	IV- java e parë gjatë tërë vitit

IV. EKO-STANDARD: Oborr i regulluar dhe i pastër

Polisa: Oborr i regullt dhe funksional që është në përputhje me nevojat për mbrojtjen e mjedisit.

Objektivi: Oborr funksional sipas regullave dhe parametrave ekologjike në mënyrë që oborri të jetë maksimalisht i përdorur për nevojat e të gjithë atyre që mësojnë të atë shkollë.

Pika e aksionit	**Subjekti**	**Përmbajtja mësimore**	**klasa./ Viti.**	**Koha e realizimit**
Mbjellje e fidaneve gjetheramese				
	Gjeografi	Edukata ndaj gjelbërimit për një obor funksional	VII	III
	Biollogji	Kontrolli ekologjik në natyrë	VII	VI- Dhe gjatë vitit

23. Programi vjetor për punën e këshillit të shkollës

Këshilli i shkollës të SHFK "Istikball" – Tetovë përbëhet prej 7 anëtarëve nga të cilët 3 janë përfaqësues nga arsimtarët, 3 anëtarë janë nga Këshilli i prindërve, 1 anëtarë nga themeluesi.

Përmbajtja e punës	**Koha e realizimit**
Shqyrtimi dhe miratimi i programit vjetor të punës së shkollës për vitin shkollor . Shqyrtimi dhe miratimi i programit të ekskursioneve për vitin shkollor 2025/2026. Formimi i komisionit për shqyrtim të ofertave për ekskursione.	
Miratimi i vendimit për regjistrimin e mjeteve dhe burimeve të tyre. Miratimi i vendimit për formimin e Komisionit për Regjistrim. Miratimi i vendimit për maksimumin e arkës. Formimi i komisionit për shqyrtimin e lutjeve të kandidatëve të paraqitur në shpallje publike në gazeta zyrtare. Mendim për kandidatët e paraqitur. Njoftim për ekskursione të realizuara.	
Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të gjysmëvjetorit për punën e shkollës. Shqyrtimi dhe formimi i komisionit për regjistrimin e Arhivës me karakter të përhershëm.	
Raport nga regjistrimi i bërë i mjeteve dhe burimeve të tyre.	
Raport financiar për zhirollogarinë përfundimtare.	
Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të shkollës për vitin shkollor 2025/26. Procedura e shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit. Shqyrtimi i ankesave të ndryshme. Të ndryshme.	

24. Programi vjetor për punën e këshillit të prindërve

Këshilli i prindërve përbëhet nga prindërit e nxënësve nga klasat dhe paralelet. Bashkëpunimi që realizohet në mes të Këshillit të prindërve dhe shkollës ka për qëllim tejkalimin e negativiteteve që paraqiten dhe përmisimin e punës edukativo arsimore në shkollë.

Përmbajtja programore	Realizuesit	Koha e realizimit
Shqyrtim dhe miratim i programës të këshillit të prindërve	Përfaqësues të këshillit të prindërve, Drejtori	Shtatori
Njoftimi me programin vjetor të shkollës për vitin shkollor 2025/2026, mendime sugjerime dhe plotësime për programin.		
Plotësimi i këshillit të prindërve me anëtar të rinj nga klasat e para.		
Shqyrtim dhe miratim i programës për ekskursione për vitin shkollor 2025/2026.		
Shqyrtimi dhe miratimi i programës së ekskurzioneve për vitin 2025/2026.		
Çështje organizative në lidhje me përgaditjet për rrjedhën e mësimit gjatë vitit shkollor Gatishmëria e objektit. Zbatim i disa aktiviteteve në shkollë me nxënësit me ndihmën e prindërve (punë shoqërore të dobishme). Informatë për ndarjen e librave pa pagesë prej klasës I – IX . Informatë për përdorimin e E-ditarit në mësim . Informatë për ndryshimin e planprogrameve mësimore për vitin shkollor 2025/2026.	Arsimtar në ciklin e ulët Pedagogu, Psikologu	
Raport për suksesin dhe sjelljen e nxënësve në tremujorin e parë në vitin shkollor 2025/26.	Pedagogu, Psikologu, Drejtori	
Gjendja shëndetësore e nxënësve		

Realizimi i funksionit social dhe shëndetësor në shkollë. Raport nga vizitat sistematike dhe stomatologjike	Kujdestarët e klasave	Nëntor
Raport për realizimin e ekskursioneve për vitin shkollor 2025/2026.	Drejtori	
Raport për suksesin dhe sjelljen e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë. Koha e lirë dhe si organizohet. Aktivitetet e lira të nxënësve.	Drejtori, Pedagogu, Psikologu	Janar
Shembuj për kremtimin e 7- marsit (ditës së arsimtarit) dhe 8-marsit (dites së gruas)	Drejtori, Pedagogu, Psikologu	Mars
Raportim për aktivitetet e ndërmara nga Proekti Integrimi ndëretnik.	Pedagogu, Psikologu	
Raport për suksesin dhe sjelljen e nxënësve në tremujorin e tretë në vitin shkollor 2025/2026.	Drejtori, Pedagogu, Psikologu	Prill
Lajmërim për fotografimin e nxënësve dhe realizimin e shëtitjes pranverore.		
Analizë e bashkëpunimit të shkollës dhe familjes (Vërejtje dhe propozime për avansim)		
Analizë për për punën në shkollë për vitin shkollor 2025/2026	Drejtori, Pedagogu, Psikologu	Qershor
Efektet nga puna shoqërore e dobishme me nxënësit		
Raport për ekskursionin pranveror të realizuar .	Drejtori	

25. KËSHILLIMI I PRINDËRVE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026

PLANI JAVOR DHE MUJOR

Muajt/Java	**AKTIVITEI-I**	**AKTIVITEI-II**
Tetor-java I	Pregaditja e ftesave / Konsultim me kujdestarët e klasave	Bisedë me kujdestarët e nxënësve,prindërit e të cilëve ftohen në këshillim.
Tetor-java II	Evidentimi i nxënësve që duhet të thirren prindërit në këshillime. Dërgimi i ftesave	Kompletimi i të dhënave Këshillim me prinder
Nëntor- java I Nëntor- java II	Konsultim me kujdestarët e klasave	Kompletimi i të dhënave Këshillim me prinder
Dhjetor-Java I Dhjetor- Java II	Konsultim me kujdestarët e klasave Evidentimi i nxënësve që duhet të thirren prindërit në këshillime.	Këshillim me prinder Këshillim me nxenes
Shkurt-Java I	Konsultim me kujdestarët e klasave	Bisedë me kujdestarët e nxënësve,prindërit e të cilëve ftohen në këshillim.
Shkurt-Java II	Evidentimi i nxënësve që duhet të thirren prindërit në këshillime.	Kompletimi i të dhënave
Mars-Java I Mars- Java II	Konsultim me kujdestarët e klasave	Kompletimi i të dhënave Këshillim me prinder
Prill-Java I Prill-Java II	Konsultim me kujdestarët e klasave Evidentimi i nxënësve që duhet të thirren prindërit në këshillime.	Këshillim me prinder Këshillim me nxenes
Maj-Java I	Konsultim me kujdestarët e klasave	Bisedë me kujdestarët e nxënësve,prindërit e të cilëve ftohen në këshillim.
Maj-Java II	Evidentimi i nxënësve që duhet të thirren prindërit në këshillime.	Kompletimi i të dhënave

VËREJTJE- Përmbatja e planifikimit të këshillimeve me prindër do të realizohen edhe sipas nevojës nga kërkesat e parashtruara nga ana e kujdestarve të klasës të cilat nuk janë të planifikuara.

26. PLANI GLOBAL VJETOR PËR PUNËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS 2025/2026

Plani global vjetor për punën e drejtorit edhe këtë vit sikurse deri më tani, kryesisht është bazuar në qëllimet e parashtruara, detyrat, kahjet, udhëzimet në dokumentet vijuese:

- Vendimet nga Ligji për Arsim Fillor si dhe ligjet dhe rregulloret tjera të cilat kanë të bëjnë me arsimin fillor, të drejtat dhe obligimet e të punësuarëve në këtë sferë;

- Planet dhe programet mësimore për Arsimin Fillor.

SHPËRNDARRJA E KOHËS SË PUNËS SË DREJTORIT (JAVORE)

Në korniza të kohës së punës 40 orëshe, drejtori i shkollës angazhimin e tij përveç tjerash e ka orientuar në aktivitetet vijuese:

1	PUNA PEDAGOGJIKO-INSTRUKTIVE	50%
2	PUNA KËSHILLUESE ME PRIND DHE NXËNËS	3%
3	BASHKËPUNIMI ME MJEDISIN E NGUSHTË DHE TË GJËRË SHOQËROR	2%
4	BASHKËPUNIMI ME ORGANET PROFESIONALE TË SHKOLLËS DHE ORGANET TJERA	5%
5	BASHKËPUNIMI ME ORGANET DREJTUESE TË SHKOLLËS	5%
6	BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E NXËNËSVE DHE KËSHILLIN E PRINDËRVE	3%
7	PUNË ADMINISTRATIVO-JURIDIKE	2%
8	PUNË ANALITIKO-HULUMTUESE	20%
9	PUNA ME EVIDENCËN DHE DOKUMENTACIONIN PEDAGOGJIK	10%
	GJITHSEJ:	100%

DETYRAT E PUNËS GLOBALE TË DREJTORIT

Duke u nisur nga qëllimet dhe detyrat e parashtruara nga dokumentet e lartëpërmendura dhe duke patur parasysh kushtet dhe kërkesat e shkollës, drejtori i shkollës gjatë vitit shkollor, aktivitetin e tij e bën veç tjerash në pyetjet dhe kërkesat vijuese për punë kualitative të shkollës si dhe për realizimin e detyrave dhe qëllimeve në të.

- Përgatitjet administrativo-teknike për fillim të suksesshëm të vitit shkollor;
- Ndarja e orëve mësimore sipas lëndëve mësimore dhe arsimtarëve;
- Ndarja e paraleleve nëpër mësojtore;
- Ndarja e udhëheqësve të klasave sipas paraleleve;
- Aktivitete rreth formimit të paraleleve të klasave të para;
- Aktivitete rreth përgatitjes së programës shkollore për punë;
- Plotësimi me kohë i vendeve të punës;
- Aktivitete për krijimin e kushteve të volitshme për punë dhe projekte në shkollë;
- Pjesmarrje në përgatitjen e orarit të mësimit dhe të kujdestarisë në shkollë;
- Aktivitete rreth organizimit dhe pjesëmarrjes së arsimtarëve në seminare për programet e reja mësimore;
- Organizimi i aktiviteteve rreth evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik për vitin e ri shkollor;
- Aktivitete rreth furnizimit me mjete konkretizuese dhe resurse të ndryshme;
- Organizimi i aktiviteteve në lidhje me ushqimin e nxënësve;
- Organizimi i aktiviteteve rreth planeve globale dhe tematike të arsimtarëve;
- Planifikimi i aktiviteteve në planin e punëve analitiko-studimore;
- Organizimi i aktiviteteve rreth punës ekipore të arsimtarëve;
- Aktivitete rreth sanimit dhe rregullimit të shkollës;
- Aktivitete rreth punës së organizatës së fëmijëve;
- Aktivitete rreth punës së këshillit të prindërve në shkollë;
- Aktivitete rreth bashkëpunimit me shkolla tjera, organe dhe organizata lidhur me punën e suksesshme të shkollës;
- Ndjekja e procesit edukativo-arsimor dhe aktivitetet për zhvillimin professional;

- Aktivitete rreth bashkëpunimit të shkollës dhe nxënësve me mjetet për informim publik, revistat e fëmijëve, etj.
- Vizita në orë mësimore dhe analiza e të njejtave;
- Ndjekja e përgatitjeve ditore të arsimtarëve dhe dhënia e këshillave në përmirësimin e kualitetit.

Si vizioni im për këtë çështje është:

"Synoj përmirësimin dhe krijimin e kushteve më të mira bashkëkohore për zhvillimin e jetës dhe punës në shkollë, si dhe perfeksionimin profesional permanent të kuadrit arsimor"

Si përfundim i programit tim të punës jap këtë koment:

"Do të mundohem ta bëj shkollën tonë mjedis në të cilën nxënësit me kënaqësi do të mësojnë dhe do t'i zgjërojnë dituritë e tyre, me ndihmën e kuadrit arsimor kompetent, ku në bashkëpunim me prindërit dhe bashkësinë lokale, do të mundësojmë që nxënësit tanë, shkollën e vetë t'a ndjejnë si shtëpi të tyre të dytë"

Përveç aktiviteteve të lartëpërmendura, angazhimi i drejtorit në vitin shkollor 2025/2026 do të jetë i orientuar në të gjitha lëmitë e veprimit të tij që do të thotë se programi është i hapur për plotësime të planifikimeve tjera.

SH.F.K." Istikball" – Tetovë

u.d. Imrja Ademi

27. PLANI GLOBAL VJETOR PËR PUNËN E NDIHMËS DREJTORIT TË SHKOLLËS - 2025/2026

QËLLIMET STRATEGJIKE

- Përparimi i kualitetit të mësimit dhe të mësuarit në Sh.F.K. "Istikball" - Tetovë;
- Implementimi i notimit përshkrues në mësimin klasor;
- Ndërtimi i sistemit të vlerësimit dhe notimit të arsimtarëve;
- Përsosja profesionale e të punësuarve;
- Implementimi i noviteteve për sistemin nëntëvjeçarëtë arsimit.

DETYRAT PRIORITARE

- Implementimi i ndryshimit dhe plotësimit të Planeve mësimore për arsimin fillor
- Implementimi i notimit përshkrues në klasët e para, të dyta dhe të treta.
- Realizimi i plotë i mësimit shtues, plotësues dhe projekteve shkollore
- Përsosja e procesit mësimor me zbatim konkret të teknikave për mësim
- Sjellja e planit strategjik zhvillimor për përparimin e shkollës

Programi vjetor për punë përfshin këto fusha:

- Administrative - organizative
- Dokumente programore
- Pedagogjike - instruktive
- Punë hulumtuese – analitike

PUNA ADMINISTRATIVE — ORGANIZATIVE

Përmbajtja e aktiviteteve	Qëllimi i aktiviteteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Realizatorë
Pjesmarje në përgatitjen e planit për angazhimin në punë të kuadrit arsimor sipas lëndëve, orëve dhe kujdestarët e klasave	Përgatitja në kohë për fillimin e vitit shkollor	-Takime me aktivet profesionale -Puna në ekipe	Gusht, shtator	Drejtor, Administratori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, bibliotekisti dhe kryetarët e aktiveve profesionale
Përgatitja e orarit për orët për vitin shkollor	Përgatitja në kohë për fillimin e vitit shkollor	Biseda dhe konsultime me arsimtarët, Punë teknike	Gusht, shtator	Drejtori, ndihmës drejtorët
Mbykqyrje në përgatitjet (planet) globale, tematike dhe ditore	Mbykqyrje dhe mbështetje profesionale në përgatitjen e planifikimeve	Mbykqyrje: Biseda dhe konsultime me arsimtarët, Punë teknike	Gusht, Shtator	Drejtori, ndihmësdrejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, kryetarët e aktiveve profesionale
Organizimi dhe realizimi i mësimit plotësus, shtues dhe aktiviteteve tjera	Përfshirja e këtij mësimi në funksion të ngritjes së kualitetit të mësimit	Mbykqyrje , Biseda dhe konsultime me arsimtarët, Punë teknike	Shtator-Qershor	Drejtori,ndihmësdrejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, kryetarët e aktiveve profesionale
Mbikqyrje në ditarët për punë të arsimtarëve	Azhurimi i evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit	Mbykqyrje, Raportet	Shtator-qershor	Drejtori, ndihmësdrejtorët, ekipi për evaluim

Përgatitja për mbajtjen e këshillit të arsimtarëve dhe të prindërve	Participim aktiv i të gjithë palëve në organizimin dhe realizimin e punës edukativo-arsimore	Takime konsultative, puna në ekipe, mbledhje	Shtator-qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, ekipi për evaluim
Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë	Ndarja e nxënësve nëpër paralele	Biseda dhe konsultime me kujdestarët e klasave	Gusht , shtator	Djetori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu.
Pjesmarje në patronatin e shkollës dhe ndihmë në organizimin dhe realizimin e garave shkollore	Përgatitja e nxënësve për pjesmarje në patronati i shkollës dhe gara komunale, regjionale dhe republikane	Orari,lajmërime dhe raporte	Tetor Shkurt,maj	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, kryetarët e aktiveve profesionale
Takime të aktiveve profesionale	Mbykqyrje në realizimin e planeve të aktiveve profesionale, programit dhe planeve mësimore	Mbykqyrje dhe raporte për të njëjtit	Shtator, qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, kryetarët e aktiveve profesionale

II. DOKUMENTE PROGRAMORE

Përmbajtja e aktiviteteve	Qëllimi i aktiviteteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Realizatorë
Përgatitja e programit vjetor për punë të shkollës	Përmbajtja në rregullativën ligjore	Raport në shkallën dhe kualitetin e realizimit të programit vjetor prej programit paraprak; shfrytëzimi i literaturës profesionale	Gusht,shtator	Drejtori, ndihmës drejtorët, dhe ekipi për përgatitjen e programit
Përgatitja e programit individual për punë të ndihmës drejtorit	Përgatitja në kohë për punë dhe detyrat për vitin në vijim	Raport për realizimin e aktiviteteve të deritashme; shfrytëzimi i literaturës profesionale	Gusht, shtator	Ndihmës drejtorët

PUNA ANALITIKE-HULUMTUESE				
Përmbajtja e aktiviteteve	ëllimi i aktiviteteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Realizatorë
Puna instruktive me arsimtarët fillestar	Dhënia e udhëzimeve për përgatitjen kualitative të planeve globale, tematike dhe ditore; Pjesëmarrje dhe dhe organizim të përmbajtjeve mësimore	Biseda individuale, Shfrytëzimi i literaurës profesionale	Shtator	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu, kryetarët e aktiveve profesionale
Ndjekja e punës në programin notimi përshkrues, kl. I ,II dhe III	Realizim i suksesshëm i programit notimi përshkrues	Mbykqyrje, seminare interne	Shtator-qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, ekipi për evaluim
Ndjekja e mësimit plotësues, shtues nëpër lëndët e veçanta mësimore	Mbykqyrja e angazhimit të arsimtarëve dhe motivimi i nxënësve	Mbykqyrje, Raport nga i njëjti	Shtator-qershor	Drejtori,ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu dhe ekipi për evaluim
Vizita në orë në mësimin (kl I)	Aktiviteti i nxënësve në procesin edukativo-arsimor	Mbykqyrje, Raport nga i njëjti	Shtator-qershor	Drejtori,ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu.
Vizita në orë në mësimin lëndor – gjuha maqedone	Pjesmarej në realizimin e programeve të reja mësimore për gj. Maqedone	Mbykqyrje, Raport nga i njëjti	Shtator-qershor	Drejtori,ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu.
Vizita në orë në mësimin kl VI	Pjesmarej në realizimin e programeve të reja mësimore përgatitor	Mbykqyrje, Raportet	Shtator-qershor	Drejtori, ndihmës drejtori, pedagogu, sociologu, psikologu.

28. PLAN PROGRAMA VJETORE E PEDAGOGUT TË SHKOLLËS

Përmbajtja e aktiviteteve	Qëllimi i aktiviteteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Realizatorë
Analiza në punë dhe zbatimi i projekteve	Analiza kualitative dhe kuantitative dhe njohja me dobitë nga zbatimi i projekteve	Mbykqyrje , Analiza	Maj-qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu dhe ekipi për evaluim
Përgatitja e analizës së raporteve për suksesin,sjelljen në gjysëmvjetor dhe fund të vitit shkollor	Analiza e suksesit të nxënësve dhe vërtetim i qëllimeve prioritarepër vitin e ardhshëm	Puna ekipore, Raportet, Analizat	Janar-qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu dhe ekipi për evaluim
Analiza në zbatimin e programit " notimi përshkrues"	Caktimi i shkallës së kualitetit të detyrave të zbatuara dhe identifikimi i vështirësive dhe problemeve në implementimn e programit	Puna ekipore, Raportet, Analizat	Qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu dhe ekipi për evaluim
Raport për shkallën dhe kualitetin e realizimit të programit vjetor për punë të shkollës	Pasqyrë reale për rezultatet e arritura dhe caktimi qëllimeve prioritare për vitin e ardhshëm	Puna ekipore, Raportet	Qershor	Drejtori, ndihmës drejtorët, pedagogu, sociologu, psikologu dhe ekipi për evaluim
Raport për mbykqyrjet pedagogjike të bëra	Ndjekja e përparimit dhe përsosjes së personelit arsimor	Puna ekipore, Raportet	Qershor	Ndihmës drejtorët

Programi i punës së pedagogut të shkollës paraqet dokument bazë për veprimin dhe realizimin e detyrave të pedagogut, duke u mbështetur në ligjet dhe rregulloret për shkollat fillore dhe bazat programore të veprimtarisë edukativo- arsimore, punës së punëtorëve profesional të shkollës fillore.

Konstatimet për vitin e kaluar shkollor e ku mbështetet Programi për këtë vit shkollor janë këto që vijojnë:

1. Puna edukativo arsimore gjatë vitit shkollor 2023-24 është realizuar në baza pedagogjike dhe metodiko-didaktike pa ndonjë problem të theksuar në mësim në kushte shkollore.
2. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore në shkollë ka vazhduar me dinamikën e duhur.
3. Pajisja e shkollës me mjete të reja bashkëkohore mundësoi vazhdimin e avansimit të kushteve për konkretizimin e mësimit në shumë lëndë si në ciklin e ulët ashtu edhe në ciklin e lartë.
4. Trend i pajisjes se shkollës me mjete mësimore ka qenë i vazhdueshëm dhe në vitin e kaluar shkollor pra në vitin shkollor 2023-2024.
5. Përdorimi i TIK dhe platformave edukative arsimore me planifikime konkrete ka kontribuar në mësim në shkollë dhe në distancë në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
6. Përsosja profesionale e arsimtarëve ka qenë në fokus të punës në aspektin e përparimit të punës mësimore në shkollë dhe mësimin në largësi-distancë.
7. Aktivitet jashtëmësimore janë realizuar aq sa kanë mundësuar kushtet për një veprimtari të këtillë.
8. Përkrahja dhe ndihma e nxënësve me pengesa dhe vështirësi në mësim si dhe ndihma direkte e arsimtarëve në këtë drejtim.
9. Ndihma dhe përkrahja e arsimtarëve dhe nxënësve në drejtim të inkluzionit në mësim.
10. Ndihma dhe përkrahja e arsimtarëve dhe nxënësve në drejtim të mësimit të rregullt në shkollë.

Duke u nisur nga kjo që u tha më lartë për atë se sa dhe si janë arritjet në vitin e kaluar shkollor, Program i pedagogut të shkollës në vitin shkollor 2024-2025, **si baza nisëse dhe objektiva do t'i ketë detyrat dhe aktivitetet që janë dhënë si detyra prioritare në Programin për punën e shkollës në vitin shkollor 2024/2025 e që janë:**

I. Përcjellja e drejtpërdrejtë e punës edukativo-arsimore në shkollë.

II. Puna konsultative këshilldhënëse me nxënës, mësimdhënës dhe prindër.

III. Puna analitiko-hulumtuese në shkollë.

IV. Përsosja profesionale kadrovike në procesin edukativo-arsimorë.

V. Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik.

VI. Avansimi i mëtejshëm i programës "Notimi përshkrues" prej klasës së I-rë deri në klasën e III-të dhe notimi i kombinuar prej klasës së IV deri në klasën e VI-të.

Shkoqitja dhe adaptimi i programeve vjetore prej klasës së I deri në klasën e IX, të cilat janë programe të reja mësimore procesuale të cilat duhet përpiluar sipas konstruksineve të këshilltarëve përkatës duke u bazuar në programet dhe tekstet e reja mësimore.

VII. – Përcjellja permanente e drejtpërdrejtë e veprimtarisë edukativo- arsimore në shkollë.

Për konkretizimin dhe realizimin e përcjelljes të kësaj veprimtarie, aktivitetet do të planifikohen në planin global dhe operativ të pedagogut të shkollës:

I. PLANI GLOBAL

1. Përcjellja permanente e drejtpërdrejtë dhe sistematike, grumbullimi i të dhënave empirike për pregaditjen dhe realizimin e mësimit të rregullt, shtues, plotësues dhe vazhdues.

2. Përcjellja e rrjedhës së veprimtarisë jashtë procesit të rregullt mësimorë dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

3. Përcjellja e veprimtarisë të ekipeve profesionale në lemitë jashtëmësimore, realizimit të programit vjetor të shkollës.

4. Përcjellja e procesit të gjithëmbarshëm mësimorë në shkollë.

5. Përcjellja, vlerësimi i rrezultateve të përgjithshme në shkollë.

6. Përcjellja dhe përsosja profesionale e kuadrit arsimorë.

7. Përcjellja dhe evidentimi konkret i punëve profesionale gjatë realizimit ditorë dhe gjatë vitit shkollorë.

8. Përcjellja e të gjitha punëve dhe të arriturat e aktiviteteve edukativo-arsimore që nuk janë në lëmitë e lartëpërmendura.

9. Pëcjellja e drejtpërdrejtë e procesit edukativo-arsimorë

10. Përcjellja e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore për vitin shkollorë 2024 / 2025, do të realizohen këto aktivitete:

Nr.	**Përmbajtjet programore**	**Bashkëpunëtorët**	**Metoda Format Mjetet**	**Koha e ealizimit**	**Ora**
1.	Përcjellja dhe mbledhja e të dhënave në vlersimin e paranjohurive të fëmijëve për rregjistrim në klasën e I-rë, të lindur prej 01.01.2018, përkatësisht deri më 31.01.2019	Drejtori Pedagogu Mësues të kl. I-ra Komisioni pranues	Biseda të lira me fëmijët.	Maj Gusht Shtator	
2.	Hospitim 30 Orë mësim lëndorë (lëndët natyrore) me qëllim të hulumtimit dhe konstatimit të mësimit të rregullt, mësim klasor dhe lëndor.	Drejtori Pedagogu Psikologu	Vizitë në orë	Viti shkollor	
3.	Përcjellja permanente e realizimit të programës shkollore.	Drejtori	Ditarët Procesverbalët e Komisioneve dhe Aktiveve	Shtator Janar Qershor	
4.	Përcjellja, pjesëmarrja, organizimi i garave shkollore nga arsimtarët.	Aktivi i klasave		Maj	
5.	Përcjellja dhe angazhimi i udhëheqësve të paraleleve të kl. IX-ta në lidhje me rregjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme.	Udhëheqësit e paraleleve të kl. IX-ta	Anketa Pyetësor	Maj Qershor	
6.	Përcjellja e realizimit të lëndëve të reja mësimore.	Drejtori Pedagogu Psikologu	Hospitim	Gjithë vitin	

II. Puna konsultative me nxënës dhe mësimdhënës.

Në këtë lëmi do të realizohen këto aktivitete:

Nr.	Përmbajtjet programore	Bashkëpunëtorët	Metodat Format Mjetet	Koha e realizimit	Ora
1.	Bashkëpunimi me komisionin, konsultime për ndërtimin e programës shkollore.	Komisioni i formuar nga Drejtori	Bisedime	Gusht Shtator	
2.	Punë konsultative me nxënës dhe mësimdhënës, aktivet profesionale për planifikime programore vjetore të reja për klasën e I-IV, për mësim të rregullt dhe per lëmi të tjera.	Arsimtarët, Aktivet profesionale	Bisedime	Gusht Shtator	
3.	Bashkëpunimi arsimtar – prind - psikolog, pedagog në lidhje me mungesat e nxënësve në orët mësimore, 10-mungesa të pa arsyeshme, 100 të arsyeshme, mbi tre nota të dobëta dhe nxënës problematik	Kujdestarët e klasave Psikologu, Pedagogu, Drejtori	Konsulltime me kujdestarët e klasave dhe prindërit.	Sipas nevojës gjatë gjithë vitit shkollorë.	
4.	Punë konsultative me udhëheqësit e klasave të ulta dhe të larta dhe bashkëpunimi me prindërit.	Mësuesit klasorë dhe lëndorë.	Bisedime	Gjithë vitin	
5.	Pjesëmarrje në mbledhjet prindore në kl VI-të në lidhje me kalimin e nxënësve prej mësimit klasor në mësim lëndor.	Udhëheqësit e mësimit klasor të kl. VI-ta.	Bisedime	Maj Shtator	

6	Konsulltime dhe këshillime për mënyrën e realizimit dhe të integrimit të Tik-ut, Edukatës, Ekologjike, A.Qytetar, detyrat e shtëpisë në përparimin e procesit arsimor në të gjitha lëndët mëimore prej klasës së I-IX- të.	Drejtori, Pedagogu Arsimtarët prej klasës së I-IX- të	Konsulltime, Këshillime	Shtator, Maj	
7.	Konsultime individuale me nxënësit që vijnë prej shkollave tjera brenda Komunës, ose kthehen prej jashtë shtetit në shkollën tonë.	Udhëheqësit e paraleleve Drejtori Pedagogu Prindërit	Bisedime	Sipas nevojës	
8.	Punë konsultative me arsimtarët e mësimit klasorë dhe lëndorë në lidhje me ekologjine dhe Projektin për integrim ndëretnik në Arsim A.Qytetarë.	Trajnuesit e shkollës Drejtori, N. drejtori Pedagogu, Sociologu, Aktivet profesionale, Arsimtarët	Konsulltime Këshillime	Sipas Nevojës gjatë tanë vitit	
9.	Punë konsulltative me arsimtarë të mësimit klasorë, lëndor në lidhje me përdorimin e TIK-ut në orët mësimore 30 përqind të plan programës mësimore	Arsimtarët e informatikës shërbimet profesionale, drejtorë, n.drejtor	Këshillime konsulltime	Gjatë tanë vitit shkollorë	

III. Puna analitike hulumtuese në shkollë

Nr.	Përmbajtjet programore	Bashkëpunëtorët	Metodat Format Mjetet	Koha e realizimit	Ora
1.	Analiza e suksesit në tre mujorin e pare, gjysëmvjetorin e pare, tre mujorin e dytë të vitit shkollor 2024 / 2025.	Drejtori, N.Drejtor	Statistike Tabelar	Janar	
2.	Analiza e suksesit në fund të vitit shkollor 2024/2025.	Drejtori, N.Drejjtori	Statistikë Tabelar	Qershor	
3.	Hulumtimi: Motivimi i nxënësve për mësim dhe suksese të reja.	Drejtori Pedagogu	Anketim Pyetësorë për	Shkurt	

		Udhëheqësit e klasës Prindërit Arsimtarët	nxënës, prindët dhe arsimtarët	Mars	
4.	Përpunimi i të dhënave dhe krahasimi i tyre me të dhënat e Entit Pedagogjik, B.Zh.A. në lidhje me mësimin aktiv.	B.Zh.A.	Listat analitike	Qershor	
5.	Hulumtimi: Roli i hulumtimit në mësimin e grupit të lëndëve natyrore.	Drejtori B.Zh.A.	Vizitë në orë, Anketim i nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve	Dhjetor	
6.	Pjesmarja në realizimin e hulumtimit që e organizon B.Zh.A.	B.ZH.A.		Sipas nevojës	
7.	Puna me udhëheqësit e paraleleve në mësim klasor dhe lëndor për realizimin e „Mësimit qytetar dhe shkencave natyrore.	Udhëheqesit e paraleleve arsimtarët e lëndëve përkatëse	Biseda		
8.	Puna me arsimtarët e klasave të ulta për avansimin e mësimit aktiv dhe të mësuarit interaktiv.	Arsimtaret e trajnuar	Biseda Vizita në orën mësimore Demonstrme	Tërë vitin	
9.	Puna e arsimtarëve klasorë dhe lëndorë në udhëheqjen e Ditarëve Elektronik.	Drejtori	Konrollime Biseda Vizita në orë	Tërë vitin	
10.	Këshilla dhe konsultime punuese në lidhje me të notuarit me shkrim dhe të kombinuar prej klasës së I-III- të dhe prej kl.IV deri në klasën e VI-të, notimi numerik prej kl. VII-IX-të.	Udhëheqësit e paraleles Pedagogu	Sqarime Vizita në orën mësimore	Shtator Dhjetor Qershor	

IV. Ngritja profesionale e kuadrit edukativo-arsimorë.

Nr.	Përmbajtjet programore	Bashkëpunëtorët	Metodat Format Mjetet	Koha e realizimit	Ora
1.	Furnizimi i arsimtarëve përkatës me material profesional dhe ligjërimi për sëmundjet e varshmërisë si duhanit, alkoholi etj.	Udhëheqësit e paraleleve të kl.IX-ta, sociologu B.Zh.A.	Foto-Ilustrime Video-Kaseta	Dhjetor	
2.	Ligjerata profesionale për këshillim arsimor në Temën: Ngritja e kulturës të nxën.në edukatën qytetare, ekologjike përmes mësimit të rregullt në gjitha lëndët mësimore prej kl.I-IX-të.	B.Zh.A. Kujdestarët e klasave dhe shërbimi profesional	Këshillime	Shtator Mars Qershor	
3.	Organizimi dhe pjesëmarrja e aktivit profesional në mbledhje të mësimit klasor në lidhje me realizimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore.	Përgjegjës të aktiveve Profesionale dhe Arsmtarët	Konsulltime Këshillime	Gusht Maj	
4.	Informimi i arsimtareve me literature, punime të reja pedagogjike-didaktike dhe metodike puna me Ditarin e nxënësve dhe D.Elektronik.	B.ZH.A. dhe M.A.SH.	Këshillime, Seminare, Literaturë me të dhëna të reja, Interneti etj.	Shtator Qershor	
5.	Pjesëmarrje në Seminare dhe forma të tjera të ngritjes profesionale të punëtorëve profesional.			Sipas nevojës	
6.	Informimi i arsimtarëve për ndryshimet e planprogrameve mësimore të klasave të I-ra dhe të IV-ta sipas dinamikës.	Keshilli arsimor i klasëve përkatese, Drejtori, Shërbimi profesional	Njoftime Këshillime	Sipas nevojës	

V. Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik

Nr.	Përmbajtjet programore	Bashkëpunëtorët	Metodat Format Mjetet	Koha e realizimit	Ora
1.	Përgaditja e Programës së Pedagogut.	B.Zh.A.		Shtator	
2.	Kontrollimi i udhëheqjes së administrates dhe dokumentacionit pedagogjik dhe punën e arsimtarit.	Drejtor, N. Drejtor Shërbimi profesional	Shiqim i Ditarëve, Librit kryesorë	Shtator Qershor	
3.	Puna konsultative me arsimtarët, nxënësit dhe prindërit për problematika të ndryshme në shkollë.	Drejtori, N.Drejtori Shërbimi professional Kujdestarët e klasave	Ditari për punë Aktivitete	Tërë vitin	
4.	Udhëheqja e dokumentaciont adekuat për punë analitike-hulumtuese		Projekte Elaborate Tabelare	Sipas datës së hulumtimit	

VI. Punë plotësuese dhe sqarime

Gjatë vitit shkollor 2024 /2025, pedagogu do të realizojë edhe aktivitete të tjera gjatë punës vijuese në shkollë. Në këtë kontekst punët plotësuse mund të jenë si vijon:

- Puna dhe angazhimi në punët e këshillave arsimore;
- Puna në këshillat e mësimit klasor;
- Puna me aktivet profesionale;
- Pjesëmarrja në punët e këshillit të prindërve, këshillime me prindërit.
- Angazhimi për punë normale të organizatave fëmirore;
- Angazhimi për organizimin e mësimit në natyrë;

29. PROGRAMA VJETORE PËR PUNËN E PSIKOLOGUT

Programi i punës së psikologut përgatitet duke marrë për bazë:

- Ligjin për arsim në shkollë fillore
- Bazat për programimin e veprimtarisë jashtë mësimore të shkollës fillore të punës së bashkëpunëtorëve profesional.
- Raport për punën e psikologut për vitin 2024/2025
- Program për punën e psikologut për vitin 2024/2025
- Program për punën e shkollës
- Raport vjetor për punën e shkollës

Detyrat e përgjithshme të punës së psikologut në shkollë fillore janë:

- Të kontriboj arsimtarët të punojnë në drejtim të angazhimit të secilit nxënës sipas aftësive të tij;
- Të organizoj dhe realizoj aktivitete të tilla ku do ti ketë parasysh këto mundësi dhe të vihen në shprehje nevoja dhe mundësitë e nxënësve të të gjitha moshave;
- Të kontriboj arsimtarët t'i shfrytëzojnë mjetet e punës që ekzistojnë në shkollë në harmoni me aftësitë individuale të nxënësve dhe karakteristikat personale të tyre;
- Ndjekje dhe hulumtim i zhvillimit intelektual, emocional, social dhe arsimor të secilit nxënës, si dhe kontribut në formimin e kushteve optimale për zhvillimin e tyre.
- Të kontriboj për organizimin efikas të punës së gjithëmbarshme edukativo-arsimore në shkollë.

Në shkollën fillore "Istikball''mësimi realizohet në gjuhën shqipe, maqedone dhe në gjuhën turke.

Aktivitetet që realizohen në shkollë nga ana e psikologut janë të grupuara në disa fusha:

1. Planifikon programin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore;
2. Përgatitja e materialeve profesionale;
3. Punë konsultative këshillëdhënëse;

4. Përparimi profesional i arsimtarëve;
5. Mbajtja e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik.

1. PLANIFIKIM, PROGRAMIM DHE ORGANIZIM I PUNËS EDUKATIVO – ARSIMORE

Në këtë fushë psikologu merr pjesë në këto aktivitete:

- Përpilim i programit vjetor për punën në shkollë;
- Përpilim i raportit vjetor për punën në shkollë;
- Përgatitje e programit personal për punë;
- Përgatitje e raportit personal për punë

Përpunimi i përmbajtjeve nga kjo fushë, psikologut i mundëson që në mënyrë efikase ta organizoj punën personale në shkollë në të gjitha fushat që punon.

2. MONITORIMI I PUNËS EDUKATIVO – ARSIMORE

Realizimi i aktiviteteve nga kjo fushë realizohet në dy drejtime:

- Vlerësimin e potencialeve dhe karakteristikave të personalitetit të nxënësve;
- Monitorimi i progresit të nxënësve sipas mundësive të tyre dhe karakteristikat e personalitetit.

Në fushën e parë psikologu punon në këtë drejtim:

- Vlerësimin e pjekurisë së nxënësve për të ndjekur shkollën ;
- Zbulimi i nxënësve me vështirësi në të mësuarit si dhe përparimi i tyre;
- Zbulimi i nxënësve me mundësi më të mëdha për përparim dhe zhvillim;
- Orientimi profesional dhe këshillimi i të rinjve.

Gjatë shtatorit dhe tetorit psikologu punon në drejtim të ndjekjes së fëmijëve të klasës së parë dhe adaptimit të tyre në jetën shkollore. Ky aktivitet realizohet përmes vizitës së orëve, bisedë me arsimtarët dhe prindërit.

Njëkohësisht në të njëjtën mënyrë në periudhën shkollore ndiqen edhe nxënësit e ciklit të ulët të cilët kalojnë në ciklin e lartë (VI).

Për orientimin profesional ka program te posaçëm e cila realizohet gjatë tërë vitit me nxënësit e klasës prej VI deri IX kurse më intensivisht me klasat e IX në muajin qershor.

Gjatë muajit maj, qershor dhe gusht testohet pjekuria e fëmijëve testohet për ndjekjen e klasës parë. Në realizimin e aktiviteteve të kësaj fushe psikologu punon me nxënësit dhe prindërit e tyre, bashkëpunon me pedagogun, defektologen arsimtarët dhe institucionet përkatëse të kësaj fushe.

Përmbajtja e kësaj fushe e përbën thelbin e punës së psikologut në shkollën fillore dhe paraqet qendrën rreth së cilës janë të përqendruara dhe prej të cilave nisen dhe orientohen të gjitha aktivitetet tjera të psikologut në shkollë.

Gjatë këtij viti shkollor planifikohet të punohet me nxënësit të cilët do të tregojnë interes të punojnë në grupe për zhvillimin e kreativitetit, të menduarit dhe inteligjencës emocionale.

Me qëllim të ndjekjes të përparimit të nxënësve sipas mundësive të tyre nga ana e psikologut do të merren më shumë aktivitete:

- Vërtetimi i ndikimit të faktorëve të cilët e përcaktojnë suksesin në mësim (tek disa nxënës, në disa paralele dhe në disa lëndë mësimore , tek arsimtarët)
- Zbulim dhe punë me nxënësit të cilët manifestojnë sjellje të papërshtatshme (mungesa, mos dëgjim të arsimtarëve, sjellje agresive).
- Aftësim i fëmijëve për mësim të pavarur.

Në klasat e para do të realizohen teste adaptimi me qëllim që të shihet se çfarë fondi të fjalëve disponojnë fëmijët dhe njëkohësisht të zbulohen ato fëmijë të cilët kanë pengesa në të folurit, dhe për të njëjtit të merën masat e duhura.

Për të pasur një pasqyrë për gjendjen e përgjithshme për problemet e caktuara dhe zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të planifikuara, do të ndiqet edhe mësimi i obligueshëm, shtues, plotësues dhe aktivitetet e lira të nxënësve, theks i posaçëm do ti kushtohet notimit të nxënësve.

Përmbajtjet nga kjo pjesë në thelb përbëjnë tërësitë e pjesës së parë të kësaj fushe. Aktivitetet e kësaj fushe janë të orientuara kah zbulimi i gjendjeve të nxënësve të cilat janë si pasojë të

aktiviteteve në shkollë, të zhvillimit të karakteristikave të personalitetit, të ndikimit të rrethit më të ngushtë dhe më të gjerë të rrethit social, ndërsa manifestohen me sjelljen në shkollë ose jashtë saj. Në realizimin e këtyre aktiviteteve psikologu përdor bisedë, ndjekje, konsultime, pyetësorë, inventar të personalitetit, instrumente matëse psikologjike, metoda sociometrike, punëtori psikologjike.

3. PËRGADITJA E MATERIALIT PROFESIONAL

Varësisht nga natyra e nevojave të shprehura nga rezultatet e fituara dhe njohuritë tjera psikologu përgatit materiale të shkruara cilat i prezanton para organeve profesionale në shkollë. Mënyra se si do të jenë të prezantuara do të varen nga vetë përmbajtja e cila do të përpunohet dhe do të jetë në këtë formë:

RAPORTE

- Nga regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë
- Nga adaptimi i fëmijëve në klasë të parë
- Nga puna personale
- Nga realizimi i projekteve në të cilën është e kyçur shkolla

ANALIZA

- Nga analizat e fjalorit të fëmijëve të klasës së parë
- Nga suksesi i tre mujorit për numrin e notave të dobëta
- Nga ndjekja e mësimit

TEMA PROFESIONALE

- Për orë klase
- Për këshillin e klasave
- Për këshillin e arsimtarëve
- Për mbledhje prindërore

4. PUNA KËSHILLËDHËNËSE – KONSULTATIVE

Sa i përket kësaj fushe të punës këshillëdhënëse konsultative të psikologut të shkollës kryhet përmes punës me nxënësit arsimtarët dhe prindërit. Aktivitetet që do të ndërmerren gjatë punës me nxënësit dhe arsimtarët do të ketë formën e bisedës këshillëdhënëse- konsultative, ndërsa gjatë punës me arsimtarët do të ketë formën e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave dhe instruksioneve.

Puna këshillëdhënëse me nxënësit do të realizohet gjatë gjithë vitit shkollor posaçërisht me ato nxënës që do të tregojnë sjellje jo adekuate, pengesa në përparim si dhe probleme tjera. Me nxënësit do të realizohen aktivitete udhëzuese, pyetje në lidhje me zhvillimin e tyre në formimin e qëndrimeve, të tyre gjithashtu do të punohet edhe në drejtim të shkathtësive jetësore në formë të punëtorive në tema të ndryshme.

Puna këshillëdhënëse-konsultative me prindërit do të realizohet gjatë tërë vitit sipas nevojës, edhe në raste specifike do të thirren prindërit nëse paraqitet ndonjë problem si p.sh suksesi i dobët, numri i madh i mungesave pa arsye.

Puna me arsimtarët në këtë fushë do të realizohet gjithashtu gjatë gjithë vitit shkollor edhe atë në lidhje me orarin, përgatitjet ditore, probleme me nxënësit si dhe pyetje tjera të cilët dalin nga puna e gjithëmbarshme e procesit edukativo-arsimor.

Bashkëpunimi psikolog-pedagog do të realizohet gjatë tërë vitin shkollor dhe disa aktivitete do t'i realizojnë bashkërisht. Gjithashtu do të bashkëpunohet edhe me drejtorin në aktivitete dhe fusha të ndryshme. Do të bashkëpunohet edhe me pedagogët dhe psikologët e qytetit, personat profesional nga byroja për zhvillimin e arsimit, qendrën medicinale, qendrën për punë sociale, si dhe institucionet tjera, me qëllim të këmbimit të përvojave dhe të dhënave.

5. NGRITJA E PËRGJITHSHME PROFESIONALE E ARSIMTARËVE

Ngritja e përgjithshme profesionale e arsimtarëve dhe punëtorëve profesional paraqet obligim permanent i lidhur ngushtë me ndjekjen e plan programeve mësimore. Në këtë kuptim psikologu realizon më shumë aktivitete.

Bashkëpunon dhe punon me arsimtarët në përgatitjen e të gjithë llojeve të mësuarit dhe aktivitetet jashtë mësimore, përparimi i komunikimit pedagogjik në atë aspekt që do të ketë dimension specifik psikologjik-pedagogjik e gjithë kjo me të vetmin qëllim të përparimit dhe suksesit në punë. Bashkëpunim në aplikimin e të gjithë risive dhe vlerësimin e efekteve nga aplikimi i tyre.

Ngritja profesionale e kuadrit arsimor në drejtim të shfrytëzimit dhe aplikimit të njohurive të reja nga lëmi e psikologjisë në punën e shkollës me qëllim të aktivizimit dhe përparimit të nxënësve sipas aftësive psiko-fizike. Ndjekja dhe pjesëmarrje në të gjitha projektet që ekzistojnë në shkollë.

Si vitet tjera edhe këtë vit shkollor psikologu aktivisht do të punoj në përkryerjen permanente profesionale. Për këtë qëllim rregullisht do ti ndjek seminaret të organizuara nga byroja për zhvillim e arsimit, merr pjesë aktive në aktivitetet e organizuara nga pedagoget dhe psikologët e qytetit të Tetovës, ndjek literaturën profesionale dhe shkëmbimin e mendimeve dhe përvojave nga kolegët e komunës dhe më gjerë me qëllim që të përparoj dhe me efikasitet të organizojë procesin edukativo-arsimor në shkollë. Të bëj zgjedhjen e metodave bashkëkohore për punë me nxënësit në përputhshmëri më aftësitë individuale dhe karakteristikat e personalitetit të nxënësve.

6. MBAJTJA E DOKUMENTACIONIT DHE EVIDENCËS PEDAGOGJIKE

Mbajtja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike ka rëndësi të madhe pasi mundëson në mënyrë më racionale ti shfrytëzojmë të dhënat, përvojat si dhe përparimin në punë. Mbajta e dokumentacionit ka rëndësi të madhe edhe për planifikimet që vijojnë në punën e shërbimit pedagogjik.

Psikologu për punën e tij mbanë këta dokumentacione:

- Ditar kronologjik për regjistrimin e aktiviteteve të përditshme.
- Fletore të posaçme për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit.
- Dokumentimi i të gjitha instrumenteve me të cilat punon, materialet e përgatitura profesionale, si dhe materiale të cilat pranohen.

Psikologu ka qasje edhe në dokumentacionin aktual në shkollë në të cilat merr pjesë si dhe në sugjerimet dhe në udhëzime të ndryshme.

PËRMBAJTJA E PLANIT OPERATIV

GUSHT

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET, FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Vëtetimi i pjekurisë së filloristëve të ardhëshëm (fëmijëve) për fillim në shkollë	Formimi i paraleleve	Zbatimi i testit për paranjohuri bisedë me fëmijët, bisedë më prindërit	Sh.profesional prindërit	Zbulimi i njohurive paraprake të tyre
Formimi i paraleleve në klasë të parë	Shpërndarja e nxënësve sipas të gjitha kritereve	Lista, Rezultate nga testimi	Sh. profesional drejtori	Adaptim i mirë i nxënësve në jetën shkollore
Pjesëmarrje në punimet e këshillit të arsimtarëve dhe aktivitete profesionale	Detyrime programi, orët	Bisedë konsultime grupore individuale	Sh.profesional Sh.profesional nga shkollat tjera	Aftësim profesional
Përgaditje për përpilimin e Programit të shkollës	Programi vjetorë për punën e shkollës	Konsultime Dokumente Programi i vjetshëm	Sh.profesional Sh.profesional nga shkollat tjera	Program kualitativ
Pjesmarje në përpilimin Programit të shkollës	Programim kualitativ i punës së shkollës	Monolog Dialog Bisedë konsultime Programi Material i shkruar	Drejtori Sh.profesional arsimtarët	Shkollë e suksesshme

SHTATOR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Pranimi i nxënësve në klasë të parë	Krijimi i raporteve pozitive ndaj shkollës dhe realizimi i kontaktit të parë arsimtar-prindër-nxënës	Programi, shtojcë material i shkruar	Sh. profesional Arsimtarët Prindët	Adaptim i suksesshëm i nxënësve
Informimi i arsimtarëve për nxënësit nga të cilët mund të pritetet zhvillim i ngadalshëm	Informim në kohë dhe marrëveshje për veprim të përbashkët	Bisedë konsultim	Sh.profesional arsimtarët	Bashkëpunim i suksesshëm
Ndjekje e përshtatmërisë e nxënësve në klasë të parë	Adaptimi i nxënësve në jetën shkollore	Vizitë në orë, bisedë me arsimtarët, bisedë me prindërit	Sh.profesional Arsimtarët prindët	Adaptim i mirë i nxënësve në jetën shkollore
Përgaditja e vështrime statistikore për nxënësit dhe kuadrit arsimorë	Vështrime të cilat nevojiten për aktivitetet e përditshme	Vështrime Orari kalendari	Sh.profesional Drejtori	Bashkëpunim i suksesshëm
Te dhënat e nxënësve në programin Emis			Psikologu Administrata	
Përgatitja plan programit – Arsimi inkluziv (femijve me nevoja te veçanta)	Vështrime të cilat nevojiten për aktivitetet e përditshme	Konsultime Biseda	Sh.profesional Drejtori Arsimatret	Bashkëpunimi i sukseshëm

TETOR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Punë konsultative-këshilldhënëse me arsimtarë rreth formimit të seksioneve të nxënësve	Formimi i drejt i grupeve për pjesëmarje në seksionet e nxënësve	Anketë bisedë	Sh.profesional Arsimtarët prindët	Gjetja e talentëve
Përgaditja e fletoreve evidentuese me nxënës për Këshill të klasave	Vështrim të suksesit të veçantë të çdo nxënësi	Fletore evidentuese	Sh.profesional	Komunikim i drejtë
Formimi i bashkësisë së nxënësve	Aktivitet rreth organizatës së fëmijëve dhe pranimit të tyre në të njëjtën	Bisedë, konsultime grupore, Programi	Sh.profesional Arsimtarët	Aktivitete me nxënësit
Ndjekje e mësimit të obligueshëm	Organizimi i orës, motivimi i nxënësve	Vizitë në orë te disa arsimtarë, konsultime bisedë	Arsimtarë nxënës	Profesionalizë në mësim
Vëzhgim në përgaditjen e arsimtarëve	Analizë në kualitetin e përgaditjeve ditore dhe tematike	Analizë, bisedë, konsultime	Sh.profesional arsimtarët	Përdorimi i modeleve të reja të përgaditjeve

NËNTOR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Puna me nxënës me sjellje të papërshtatshme (mungesa,ikje nga ora)	Punë këshilldhënëse dhe gjetja e mënyrave për tejkalimin e gjendjes	Bisedë Anketë këshillime	Psikologu Nxënësit prindërit	Mësimi fillorë i obliguar
Ndjekje të mësimit të obliguar sipas iniciativës personale në lidhje me përmbajtjet prej të drejtave të fëmijëve	Interesimi i fëmijëve për përmbajtjet që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre	Vizitë në orë bisedë fletë evidence	Psikologu Arsimtari nxënësi	Përvetsim më i mirë i vështirsive
Ndjekja e vlersimit dhe numri i notave të dobta sipas lëndëve dhe klasave	Përpunim statistikorë dhe analizë e suksesit të nxënësve	Material i shkruar, vështrim në ditarët e klasave	psikologu	Përmirsim i suksesit
Punë këshilldhënëse me nxënës me tre ose me mëtepër nota të dobta	Ndjekja dhe gjetja e shkaqeve për suksesin e dobët te disa nxënës	Konsultime Bisedë Ndjekje test	Psikologu Arsitarët nxënësit	Përmirsim i suksesit
Punë me bashkësinë e klasës në klasë të nënta	Gjetja e shkaqeve për sjellje agresive	Bisedë Punë individuale dhe grupore	Psikologu nxënësit	Vlerat e drejta morale
Përgaditja e temave profesionale për Këshill të arsimtarëve	Aftësimi profesional i kuadrit mësimorë	Material i shkruar lexim	Sh.profesional	Profesionalizëm në mësim
Ndihmë arsimtarëve në përpilimin e testeve të njohurive,përdorimi m i kriterit dhe kodeksit etik për vlersim	Aftësimi i arsimtarëve për zbatimin praktik në krijimin e kriterit të ri për vlersim	Puntori Literaturë profesionale	Sh.profesional arsimtarët	Vlersim objektiv

DHJETOR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Ndjekja e aktiviteteve jashtëmësimore	Realizimi i programeve mësimore dhe rritja e zhvillimit të nxënësve	Konsultime, bisedë, fletë evidencë	Sh.profesional Arsimtarët prindërit	Kultivimi i shpirtit garues
Analizë të aktiviteteve të cilët janë realizuar dhe cilat jo	Vërteteimi i aktiviteteve prioritare	Analizë programi vjetorë	Sh.profesional	Efikasiteti në punë
Ndjekja e ligjeratës profesionale dhe revistave më të reja	Aftësim profesionat	Libra profesional personal,revista	Sh.profesional	Profesionalizëm në punë
Ndjekja dhe realizimi i aktiviteteve nga projekti integrim ndëretnik në arsim	Planet akcionale	Punëtori Punë në grupe	Koordinatori i projektit, arsimtarët	Realizimi i suksesshëm i planeve aksionale

JANAR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET, FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Analizë të suksesit të nxënësve	Ndjekje të vlersimit në gjysëmvjetorin e parë	Bisedë Ditarët e klasave	Arsimtarë Sh.profesional	Raport për gjysëmvjetorin e parë
Pjesëmarje në punën e Këshillit të klasave	Analizë të realizimit të programit, suksesit, rregullshmërisë së nxënësve në gjysëmvjetorin e parë	Mbledhje, bisedë, raport nga arsimtarët klasorë	Arsimtarët Sh.profesional drejtori	Realizimi i suksesshëm i programit në gjysëmvjetorin e parë
Bashkpunim me arsimtarët	Rregullimi i evidencës dhe dokumentacioni pedagogjik	Konsultime	Arsimtarët Sh.profesional drejtori	Respektimi i normës ligjore
Raport gjysëmvjetori për shkollën	Pjesëmarje në përpilimin e raportit	Matelial i shkruar, konsultime	Drejtori Sh.profesional	Përgjegjësi në punë
Përgaditja e raportit për gjysëmvjetorin	Raport për punën personale në gjysëmvjetorin e parë	Material i shkruar	psikologu	Respektim i obligimeve

SHKURT

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Punë këshillëdhënëse me nxënësit	Gjetja e shkaqeve për suksesin e dobët dhe përmirsimin e tij	Bisedë konsultuese, këshillim	Nxënësit Psikologu prindi	Udhëzime për përmirsimin e sukseseit dhe sjelljes
Bisedë këshillëdhënëse-konsultative me arsimtarë dhe prindër	Përmirsimi i suksesit	Bisedë	Psikolog Arsimtarë prindër	Largimi i dobësive për sukses të dobët
Bashkëpunimi me bashkësitë e klasave të VII dhe IX në lidhje me zbatimin e principit demokratik të vendosjes	Ndjekja e përvetsimit të njohurive për aftësitë e vendosjes demokratike	Bisedë Këshillë Konsultime anketë	Psikolog Arsimtarë nxënës	Njohuri dhe aftësi për vendosje demokratike
Realizimi i aktiviteteve në bashkpunim me prindërit	Përbarimi i formave të bashkëpunimit	Konsultime puntori	Psikolog prindër	Bashkëpunimi më i madh i shkollës me prindërit

MARS

PëRMBATJA	QËLLIMI	MJETET, FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Ndjekja e procesuar dhe planifikim të integruar të arsimtarëve dhe portfolive të tyre	Ndjekje në zbatim të procesit për planifikim të integruar të arsimtarëve	Bisedë, Këshilla konsultime	Sh.profesional Arsimtarë drejtor	Planifikimi i suksesshëm i arsimtarëve
Ndjekje të mësimit shtues	Ndjekje të nxënësve me aftësi më të mëdha për përparim dhe zhvillim	Bisedë këshilla	Arsimtarët nxënësit	Zhvillimi i shpirtit garues
Aktivitetet me rastin e 8 Marsit	Shënimi i ditës së gruas	aktivitet	Arsimtarët nxënësit	Emancipimi i gjinisë femrore
Aktivitetet për realizimin e aksioneve ekologjike nga projekti Integrim për mbrojtje të mjedisit jetësor	Shënimi i ditës botërore të ekologjisë dhe integrim të përmbajtjrve arsimore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësorë	Aksion grupe	Sh.profesional Arsimtarët nxënësit	Zbatimim i standardeve EKO në nivel të shkollës
Puntori për Bulizmin. Bulizmi një fenomen shqetësues nëpër shkolla, cilat janë faktorët kryesor të bulizmit dhe si ta parandalojmë bulizmin.	Qëllimi i se cilës është vetëdijsimi i nxënësve se çka është dhuna, si paraqitet, ne sa mënyra dhe si mund ta parandalojmë. Të vetëdisohen nxënësit se edhe ata me verpime të vogla mund të parandalojnë një të keqe të madhe siç është dhuna	Fleta pune, materiali i prezentuar me poëer point	Psikologu Nxenesit kl V- IX	

PRILL

PERMBATJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Analizë të suksesit, sjelljes dhe rregullshmërisë së nxënësve	Ndjekje të përparimit të nxënësve në tremujorshin e tretë	Bisedë Individuale dhe grupore	Drejtori Sh.profesional arsimtarët	Njohuri kualitative të nxënësve
Orientim profesional i nxënësve	Analizë të interesave dhe dëshirave për të ardhmen e tyre, profesioni – konflikti në lidhje me këtë	Fletë anketimi ligjerata	Nxënës të klasës së IX Psikologu pedagogu	Zgjedhja e drejtë e profesionit të tyre
Bashkëpunimi me arsimtarët	Orë mësimore, përdorimi i mjeteve ndihmëse, formave dhe metodave	Konsultime Ndjekje Vëzhgim në orë	Sh.profesional arsimtarët	Mësim kualitativ
Puntori –Si të mësojm më mirë		Prezentimi me poëer point dhe fleta pune, puntori	Psikologu Nxënësit kl. VI	

MAJ

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET, FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Aktivitete me ekipin për përkrahje të projektit Integrim ndëretnik në arsim	Ndjekje të punës të ekipit profesional për përkrahje të projektit	Takime puntori	Arsimtarë përgjegjës Sh.profesional	Realizimi i programit
Verifikimi i pjekurisë së fëmijëve për nisje në klasë të parë	Regjistrimi i fëmijëve në shkollë	Test për paranjohuri bisedë	Psikologu Defektologu Prindër Nxënës	Krijimi i paraleleve

QERSHOR

PËRMBAJTJA	QËLLIMI	MJETET,FORMAT DHE METODAT	BASHKËPUNTOR	EFEKTET E PRITURA
Pjesëmarje në punën e Këshillit të klasave dhe Këshillit të arsimtarëve	Përfundim i vitit shkollor	Bisedë grupore dhe individuale	Drejtori Sh.profesional arsimtarët	Përfundim i suksesshëm i vitit shkollorë
Përpilimi i Raportir Vjetor për punën e shkollës dhe Raport Personal	Vështrim real për punën gjatë vitit shkollorë	Ekipore, Individuale Material i shkruar	Sh.profesional drejtori	Raport kualitativ
Kontrollimi i ditarëve për vitin shkollorë nga e I deri në të IX	Kontrollim i punës së arsimtarëve	Kontrollim, Material i shkruar	Sh.profesional drejtori	Punë e suksesshme për tërë vitin shkollor

Psikologe : Mereme Ismani

30. PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E BIBLIOTEKISTIT TË SHKOLLËS

Nr.	Aktivitetet	Koha e realizimit	Realizues	
1 **2** **3**	• Kujdesi për funksionim normal të bibliotekës • Formimi i seksionit-Bibliotekistët e rinj • Zmadhimi permanent i fondit të librave	**Shtator** **Qershor**	Bibliotekisti	
1 **2**	• Kujdesi ndaj librit dhe ruajtja e tij • Informimi i nxënësve dhe i arsimtarëve me titujt e rinj	**Nëntor**	Bibliotekisti	
1 **2** **3**	• Afrimi i lexuesit me librin • Zgjerimi i rrethit të lexuesve në shkollë • Zgjerimi i rrethit të lexuesve në bibliotekën amë	**Dhjetor**	Bibliotekisti	
1 **2**	• Shpërndarje lektyra nxënësve • Rregullimi gjeneral i lokalit të bibliotekës	**Permanent**	Bibliotekisti	
1 **2** **3**	• Bashkëpunimi me bibliotekat e shkollave të tjera • Vizitë një shtypëshkronjeje • Pjesëmarrje në akcionin "Muaji i librit"	**Shkurt** **Mars**	Bibliotekisti	
1 **2** **3**	• Bashkëpunim me bibliotekën e qytetit • Kultivimi i dashurisë ndaj librit dhe leximit • Mbledhja e librave dhe revistave të tjera (të vjetra)	**Prill**	Bibliotekisti	
1 **2**	• Organizimi i ligjeratave nga ana e bibli. profesionalë • Rregullimi i fondit të librave në bibliotekë	**Maj**	Bibliotekisti	
1 **2**	• Kthimi i librave, i lektyrave nga ana e nxënësve e të tjerëve në bibliotekë • Përgatitja e bibliotekës për shërbim në vitin e ri shkollor, pastritimi i lokalit etj.	**Qershor**	Bibliotekisti	
	Bibliotekiste: Kujtime Beqiri			

Komisioni për përgatitjen e programit vjetor

1. Imrja Ademi – u.d. Drejtor
2. Maida Sherifi – Pedagoge
3. Mereme Hismani – Psikologe
4. Nurane Denjalli - Sociologe
5. Sejla Salii - Mësimdhënëse klasore
6. Kujtime Arifi– Bibliotekiste
7. Luba Kostadinovska- Mësimdhënëse lëndore
8. Hedije Mehmedi Abduli - Mësimdhënëse lëndore
9. Tara Shahini – përfaqësuese e parlamentit të nxënësve

Drejtor : Kryetar i këshillit të shkollës :

_____ _____

Gusht 2025

Tetovë

Literatura e përdorur:

Byroja për zhvillimin e arsimit

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

SHFK " Istikball " –TETOVË

Këshilli shkollës i propozon për miratim këtë Plan vjetor për punë 2025 / 2026

Këshillit Komunal - Tetovë

u.d. Imrja Ademi